

LIGJ
Nr.9751, datë 7.6.2007

PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7638, DATË 19.11.1992
“PËR SHOQËRITË TREGTARE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.7638, datë 19.11.1992 “Për shoqëritë tregtare”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 40 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 40

Të gjitha pjesët e kapitalit themeltar duhet të nënshkruhen, në tërësinë e tyre, nga ortakët, si për rastet kur përfaqësojnë kontribute në natyrë, ashtu edhe për kontributet në para. Ato nuk mund të përfaqësojnë kontribute në shërbime. Pjesëmarrja në kapitalin themeltar shënohet në statut.”.

Neni 2

Pas nenit 78 shtohet neni 78/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 78/1

Njoftimi gjatë themelimit të një shoqërie anonime me oferta publike

Njoftimi i parashikuar në pikën 2 të nenit 78 të këtij ligji botohet në një gazetë të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore, përpara fillimit të veprimtarive për nënshkrim dhe përpara çdo veprimi tjetër publikimi.

Ky njoftim tregon emërtimin e shoqërisë, shumën e kapitalit themeltar që duhet nënshkruar, adresën e parashikuar të selisë së shoqërisë, një përmbledhje të objektit të shoqërisë, kohëzgjatjen e shoqërisë, kur ajo është e përcaktuar, datën dhe vendin e depozitimit të projektstatutit, si dhe:

a) numrin e aksioneve për kontributin në para, që janë për t’u nënshkruar dhe shumën që kërkohet menjëherë;

b) vlerën nominale të aksioneve, që janë për t’u emetuar;

c) përshkrimin e përmbledhur të kontributeve në natyrë, vlerësimin global të tyre dhe mënyrën e shlyerjes;

ç) përparësitë e veçanta, të formuluar në projektstatut, të cilat i përfiton çdo person;

d) kushtet e pranimit dhe të ushtrimit të së drejtës së votës në mbledhjet e asamblesë së aksionerëve;

dh) në qoftë se është e nevojshme, klauzolat përkatëse për miratimin e personave që i shesin aksionet e tyre;

e) dispozitat përkatëse për shpërndarjen e fitimeve, krijimin e rezervave dhe shpërndarjen e shumës, që mbetet pas likuidimit të shoqërisë;

ë) emrin dhe adresën e noterit ose emërtimin dhe selinë e bankës, ku do të depozitohen fondet e ardhura nga nënshkrimi;

f) afatin e caktuar për nënshkrim, duke lënë të hapur mundësinë e mbylljes së parakohshme të nënshkrimit, nëse nënshkrimi është bërë i plotë, përpara përfundimit të afatit të mësipërm;

g) mënyrën e thirrjes së asamblesë themeluese dhe vendin e mbledhjes.

Njoftimi nënshkruhet nga themeluesit e shoqërisë, të cilët shënojnë emrat, mbiemrat, adresat e banimit dhe shtëpinë ose emërtimin, formën, selinë dhe shumën e kapitalit themelor të shoqërisë së tyre.”.

Neni 3

Pas nenit 80 shtohet neni 80/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 80/1

Prospektet dhe qarkoret

Prospektet, për qëllim reklame dhe qarkoret, që informojnë botimin për emetimin e aksioneve, përmbajnë të njëjtat njoftime si ato të parashikuara në nenin 78/1, si dhe shënimin se njoftimi është botuar në një gazetë të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore, duke dhënë referencën për emrin e gazetës dhe numrin ku është botuar njoftimi.

Gjithashtu, ato duhet të paraqesin, në mënyrë të përmbledhur, projektet e themeluesve për sa i përket përdorimit të fondeve, që vijnë nga shlyerja e aksioneve të nënshkruara.”.

Neni 4

Pas nenit 81 shtohet neni 81/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 81/1

Të dhënat e buletinit të nënshkrimeve

Buletini i nënshkrimeve, i parashikuar në nenin 81 të këtij ligji, përmban datën dhe firmën e nënshkruesit ose të personit të autorizuar prej tij me prokurë, i cili shkruan edhe me shkronja numrin e aksioneve që ai nënshkruan. Atij i jepet një kopje e buletinit.

Në buletinin e nënshkrimeve përcaktohen emri i shoqërisë, shuma e kapitalit themeltar për t’u nënshkruar, adresa e parashikuar e selisë së shoqërisë, një përmbledhje e objektit të shoqërisë, data dhe vendi i depozitimit të projektstatutit, si dhe:

a) nëse është e nevojshme, pjesa e kapitalit në para, që duhet nënshkruar dhe pjesa e kapitalit, që vjen nga kontributet në natyrë;

b) mënyra e emetimit të aksioneve, të nënshkruara për kontributin në para;

c) emri dhe adresa e noterit ose emri dhe selia e bankës, ku do të depozitohen fondet e ardhura nga nënshkrimi;

ç) emri, mbiemri dhe adresa e banimit të nënshkruesit, si dhe numri i letrave me vlerë, të nënshkruara prej tij;

d) shënimin për dhënien nënshkruesit të një kopjeje të buletinit të nënshkrimeve;

dh) data e botimit të njoftimit, të parashikuar në nenin 78/1 të këtij ligji, në një gazetë të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore.”.

Neni 5

Pas nenit 146 shtohen nenet 146/1, 146/2, 146/3 dhe 146/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 146/1

Drejtimi i mbledhjes së asamblesë

Mbledhjet e asamblesë së aksionerëve drejtohen nga kryetari i këshillit mbikëqyrës ose, në

mungesë të tij, nga personi i parashikuar në statut, përndryshe vetë asambleja zgjedh një drejtues të mbledhjes së saj. Në rast thirrjeje të asamblesë nga ekspertët kontabël të autorizuar, nga një mandatmbajtës i autorizuar nga gjykata ose nga likuiduesit, mbledhja e asamblesë drejtohet nga personi ose njëri prej personave, që e kanë thirrur këtë mbledhje. Drejtuesi i asamblesë cakton një sekretar që, me përjashtim të rasteve kur në statut ka dispozita të kundërta, mund të mos jetë aksioner.

Neni 146/2

Evidenca e pjesëmarrjes

Evidenca e pjesëmarrjes së aksionerëve në mbledhjen e asamblesë, e parashikuar në nenin 142 të këtij ligji, përmban:

a) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo aksioneri të pranishëm, numrin e aksioneve që ai zotëron, si dhe numrin e votave që u përgjigjet këtyre aksioneve;

b) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo aksioneri të përfaqësuar, numrin e aksioneve që ai zotëron dhe numrin e votave që u përgjigjet këtyre aksioneve;

c) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo mandatmbajtësi, numrin e aksioneve të personave, që ia kanë dhënë atij këtë mandat, si dhe numrin e votave që u përgjigjet këtyre aksioneve;

ç) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të çdo aksioneri, që i ka çuar me korrespondencë shoqërisë një formular vote, si dhe numrin e aksioneve që ai zotëron e numrin e votave që u përgjigjet këtyre aksioneve.

Evidenca e pjesëmarrjes, e nënshkruar sipas rregullave nga aksionerët e pranishëm dhe mandatmbajtës, vërtetohet nga drejtuesi dhe sekretari i asamblesë.

Neni 146/3

Procesverbali

Në procesverbalin e çështjeve të shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë përcaktohen data dhe vendi i mbledhjes, mënyra e thirrjes, rendi i ditës, emri i drejtuesit dhe i sekretarit të asamblesë, numri i aksioneve, me të cilat është votuar dhe kuorumi i arritur, dokumentet dhe raportet e shqyrtuara në mbledhjen e asamblesë, një përmbledhje e debateve, teksti i vendimeve të kaluara në votim dhe rezultati i votimit.

Procesverbali nënshkruhet nga drejtuesi dhe sekretari i asamblesë.

Neni 146/4

Ruajtja e evidencave të pjesëmarrjes dhe e procesverbaleve

Evidencat e pjesëmarrjes dhe procesverbalet ruhen në selinë e shoqërisë.”.

Neni 6

Pas nenit 151 shtohet neni 151/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 151/1

Shpallja e emetimit

Aksionerët vihen në dijeni për emetimin e aksioneve të reja dhe për mënyrën e emetimit nëpërmjet një shpalljeje, ku përcaktohen emetimi i shoqërisë, shuma e kapitalit themeltar, adresa e selisë së shoqërisë, numri i regjistrimit në regjistrin tregtar dhe:

a) shuma e zmadhimit të kapitalit;

b) datat e hapjes dhe të mbylljes së nënshkrimeve;

c) qenien në dobi të aksionerëve të së drejtës së përparësisë në nënshkrimin e aksioneve të reja, si dhe kushtet e ushtrimit të kësaj të drejte;

ç) vlera nominale e aksioneve për kontributin në para që duhet nënshkruar dhe, në qoftë se është e nevojshme, shuma e primit të emetimit;

d) shuma që kërkohet të paguhet menjëherë nga aksionet e nënshkruara;

dh) emri i personit fizik ose emri i shoqërisë, adresa e banimit ose e selisë së depozituesit;
e) nëse është e nevojshme, përshkrimi i përmbledhur, vlerësimi dhe mënyra e shlyerjes së kontributeve në natyrë, që përmbahen në zmadhimin e kapitalit, duke treguar karakterin e përkohshëm të këtij vlerësimi dhe të kësaj mënyre shlyerjeje;

ë) shënimi se, nëse aksionet e përshkruara përfaqësojnë më shumë se tre për qind të zmadhimit të kapitalit, nënshkrimi do të jetë i hapur për publikun e gjerë ose do të quhet i mbyllur me shumën e nënshkrimeve të kryera.

Nëse shoqëria është me ofertë publike, shpallja futet në një njoftim të botuar në një gazetë të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore. Ky botim duhet të bëhet i njohur për publikun të paktën 6 ditë përpara datës së hapjes së nënshkrimit.

Në rast të kundërt, njoftimet e parashikuara në paragrafin e mësipërm, brenda të njëjtit afat, u bëhen të njohura aksionerëve me letër rekomande me përgjigje për marrjen e lajmërimit.”.

Neni 7

Pas nenit 152 shtohen nenet 152/1, 152/2, 152/3 dhe 152/4 me këtë përmbajtje:

“Neni 152/1

Përfashtimi, në rast se hiqet dorë nga e drejta e përparësisë

Në qoftë se asambleja ka vendosur për të hequr dorë nga e drejta e përparësisë së aksionerëve në nënshkrim, dispozitat e nenit 151/1 të këtij ligji nuk zbatohen.”.

Neni 152/2

Përmbajtja e njoftimit për publikun

Njoftimi, i përmendur në paragrafin e dytë të nenit 151/1 të këtij ligji, përmban këto të dhëna:

- a) përmbledhjen e objektit të shoqërisë;
 - b) datën e përfundimit normal të shoqërisë, kur kohëzgjatja e saj është përcaktuar;
 - c) kategoritë e aksioneve të emetuara dhe karakteristikat e tyre;
 - ç) përparësitë e veçanta, të formuluar në statut, në dobi të çdo personi;
 - d) kushtet e pranimit dhe të ushtrimit të së drejtës së votës në asamblëtë e aksionerëve;
 - dh) në qoftë se është e nevojshme, klauzolat e statutit, që kufizojnë shitjen e lirë të aksioneve;
 - e) dispozitat përkatëse për shpërndarjen e fitimeve, krijimin e rezervave dhe shpërndarjen e shumës, që mbetet pas likuidimit të shoqërisë;
 - ë) në qoftë se është e nevojshme, shumën e obligacioneve të konvertueshme në aksione, të emetuara më parë, afatet e ushtrimit të mundësisë, që u është dhënë prurësve ose shënimin se konvertimi mund të bëhet në çdo kohë, si dhe bazat e konvertimit;
 - f) shumën e paamortizuar të obligacioneve të tjera, që janë emtuar më parë dhe garancitë, me të cilat ato janë shoqëruar;
 - g) shumën e huave të garantuara nga shoqëria dhe, në qoftë se është e nevojshme, pjesën e garantuar të këtyre huave gjatë procesit të emetimit.
- Njoftimi përmban nënshkrimin dhe vulën e shoqërisë.

Neni 152/3

Bilanci që duhet t'i bashkëngjitet njoftimit

Një kopje e bilancit të fundit, e vërtetuar, sipas rregullave, nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë, botohet si aneks i njoftimit që parashikon neni 152/2. Në qoftë se bilanci i fundit është botuar sipas rregullave të parashikuara me ligjin e veçantë për botimet e regjistrit tregtar dhe të legjislacionit në fuqi, për tregtimin e letrave me vlerë, kopja e këtij bilanci mund të zëvendësohet me një shënim, ku jepet referenca e botimit të mëparshëm.

Neni 152/4

Prospektet dhe qarkoret

Prospektet, për qëllime reklame dhe qarkoret, që informojnë publikun për emetimin e aksioneve, përmbajnë të njëjtat njoftime si ato të parashikuara në nenin 152/2 të këtij ligji, si dhe shënimin se njoftimi është botuar në një gazetë zyrtare të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore, duke dhënë referencën për emrin e gazetës dhe numrin e saj, ku është botuar njoftimi.”.

Neni 8

Pas nenit 159 shtohet neni 159/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 159/1

Të dhënat e buletinit të nënshkrimeve

Në buletinin e nënshkrimeve, të parashikuara në nenin 159 të këtij ligji, shënohet data dhe nënshkrimi i nënshkruesit ose mandatmbajtësit, që shkruan edhe me shkronja numrin aksioneve të nënshkruara prej tyre. Atij i jepet një kopje e buletinit.

Buletini i nënshkrimeve përmban emrin e shoqërisë, shumën e kapitalit themeltar, adresën e selisë së shoqërisë, numrin e regjistrimit të shoqërisë në regjistrin tregtar dhe:

- a) shumën dhe mënyrat e zmadhimit të kapitalit;
- b) në qoftë se është e nevojshme, shumën për t’u nënshkruar të aksioneve për kontributet në para dhe shumën e shlyer për kontributet në natyrë;
- c) emrin dhe adresën e noterit ose emrin dhe selinë e bankës, ku do të depozitohen fondet e ardhura nga nënshkrimi;
- ç) emrin, mbiemrin dhe adresën e banimit të nënshkruesit, si dhe numrin e letrave me vlerë të nënshkruara prej tij;
- d) njoftimin se nënshkruesit i është dhënë një kopje e buletinit të nënshkrimeve.”.

Neni 9

Në nenin 187 paragrafi i dytë ndryshohet si më poshtë:

“Vendimi për shndërrim botohet sipas legjislacionit që rregullon botimet e shoqërive tregtare.”.

Neni 10

Në nenin 190 paragrafi i tretë ndryshohet si më poshtë:

“Në të dyja rastet zgjidhja e dhënë nga asambleja e përgjithshme botohet sipas legjislacionit që rregullon botimet e shoqërive tregtare.”.

Neni 11

Pas nenit 244 shtohet neni 244/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 244/1

Projekti i bashkimit ose i ndarjes

Projekti i bashkimit ose i ndarjes formulohet nga drejtorja, administratori ose administratorët e secilës prej shoqërive, që marrin pjesë në operacionin e bashkimit ose të ndarjes së projektuar. Ai duhet të përmbajë të dhënat e mëposhtme:

- a) formën, emrin dhe selinë e të gjitha shoqërive pjesëmarrëse;
- b) motivet, qëllimet dhe kushtet e bashkimit ose të ndarjes;
- c) caktimin dhe vlerësimin e aktivitetit dhe të pasivit, që janë parashikuar t’u kalojnë shoqërive përthithëse ose të reja;
- ç) mënyrat e dorëzimit të pjesëve të kapitalit themeltar ose aksioneve dhe datën, pas së cilës këto pjesë ose aksione japin të drejtën për pjesëmarrje në fitime, si dhe çdo modalitet të veçantë, që lidhet me këtë të drejtë. Gjithashtu, projekti duhet të përmbajë datën, pas së cilës operacionet e

shoqërisë së përthithur ose të ndarë vlerësohen, në aspektin e kontabilitetit, si të kryera nga shoqëria ose shoqëritë që përfitojnë kontributet;

d) datat, në të cilat janë hartuar llogaritë e shoqërive të interesuara, që përdoren për të formuluar kushtet e operacionit;

dh) raportin e këmbimit të të drejtave në shoqëri dhe, në qoftë se është e nevojshme, shumën që duhet paguar për të kompensuar pabarazinë e këtyre të drejtave të këmbyerë;

e) shumën e parashikuar të primit të bashkimit ose të ndarjes;

ë) të drejtat e dhëna ortakëve, që kanë të drejta të veçanta dhe prurësve të letrave me vlerë, të ndryshme nga aksionet, si dhe, në qoftë se është e nevojshme, të gjitha përparësitë e veçanta.”.

Neni 12

Në nenin 248 fjalja e fundit e paragrafit të tretë shfuqizohet.

Neni 13

Pas nenit 248 shtohen nenet 248/1 e 248/2 me këtë përmbajtje:

“Neni 248/1

Shpallja e projektit të bashkimit ose të ndarjes

Projekti i bashkimit ose i ndarjes botohet edhe në formën e një shpalljeje në një gazetë, të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore, nga secila prej shoqërive që marrin pjesë në operacion.

Kjo shpallje përmban të dhënat e mëposhtme:

a) emrin e shoqërisë, adresën e selisë, shumën e kapitalit dhe numrat e regjistrimit në regjistrin tregtar të secilës prej shoqërive që marrin pjesë në operacion;

b) emrin e shoqërisë, adresën e selisë dhe shumën e kapitalit të shoqërive të reja, që do të dalin nga operacioni, ose shumën e zmadhimit të kapitalit të shoqërive ekzistuese;

c) vlerësimin e aktivitetit dhe të pasivitetit, të cilët janë parashikuar t’u kalojnë shoqërive përthithëse ose të reja;

ç) raportin e këmbimit të të drejtave në shoqëri;

d) shumën e parashikuar të primit të bashkimit ose të ndarjes;

dh) datën e projektit, si dhe datën e vendin e depozitimeve, të parashikuara në paragrafin e dytë të nenit 248 të këtij ligji dhe botimi, i parashikuar në shkronjat e përmendura më lart, duhet të bëhet të paktën një muaj përpara datës së mbledhjes së parë të asamblesë, të thirrur për të marrë vendim për operacionin.

Neni 248/2

Deklaratë në përputhje me rregullat

Deklarata e parashikuar në paragrafin e tretë të nenit 248 të këtij ligji depozitohet në regjistrin tregtar.

Ajo duhet të nënshkruhet të paktën nga një anëtar i drejtorisë ose nga administratori i secilës prej shoqërive pjesëmarrëse, që kanë një mandat për këtë qëllim.

Një kopje depozitohet në regjistrin tregtar, për çdo shoqëri pjesëmarrëse.”.

Neni 14

Në nenin 255 fjalja e parë e paragrafit të dytë ndryshohet si më poshtë:

“Kreditorët e shoqërive, që marrin pjesë në operacionin e bashkimit dhe që kanë dhënë kredi para botimit të projektbashkimit, mund ta kundërshtojnë bashkimin, brenda një afati prej 30 ditësh, duke filluar nga data e botimit të regjistrimit në regjistrin tregtar apo në gazetën e autorizuar për

botimin e njoftimeve ligjore, cilado qoftë data e mëvonshme.”.

Neni 15

Pas nenit 265 shtohet neni 265/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 265/1 **Emërimi i likuiduesve**

Emërimi dhe të dhënat e likuiduesve duhet të regjistrohen në regjistrin tregtar, së bashku me aktin e emërimit.”.

Neni 16

Pas nenit 279 shtohet neni 279/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 279/1 **Shpallja e mbylljes së likuidimit**

Shpallja e mbylljes së likuidimit, e nënshkruar nga likuiduesi dhe nën kujdesin e tij, botohet në një gazetë, të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore dhe regjistrohet në regjistrin tregtar.

Në shpallje jepen emri i shoqërisë, shuma e kapitalit themeltar, adresa e selisë së shoqërisë, numri i regjistrimit në regjistrin tregtar, si dhe:

- a) emrat, mbiemrat dhe adresat e banimit të likuiduesve;
- b) data dhe vendi i mbledhjes së asamblesë për mbylljen, në qoftë se llogaritë e likuiduesve janë miratuar prej saj ose, në rast të kundërt, data e vendimit gjyqësor, të parashikuar në nenin 271 të ligjit, si dhe gjykata që e ka marrë këtë vendim.”.

Neni 17

Pas nenit 302 shtohet neni 302/1 me këtë përmbajtje:

“Neni 302/1 **Caktimi i gazetave të autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore**

Gazetat e autorizuar për botimin e njoftimeve ligjore caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 18

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.5369, datë 25.6.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Alfred Moisiu**